

AGJENCIA PËR MENAXHIMIN E
KOMPLEKSEVE MEMORIALE TË KOSOVËS

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agjencia za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

DATË/A:	25.03.2016
REFERENC-Ë:	32/03/16
PËR/ZA/TO:	Z. Kadri Veseli, Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës
CC:	Komisioni Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor - Kuvendi i Republikës së Kosovës
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Idriz Blakaj, Drejtor i AMKMK-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Raporti Vjetor i AMKMK-së

I nderuar z. Kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Përmes kësaj shkrese po iu dërgojmë Raportin Vjetor të AMKMK-së për vitin 2015.

Bashkëngjitur me këtë Raport Vjetor do të keni:

- Raportin Financiar të AMKMK-së për vitin 2015;
- Planin e punës së AMKMK-së për vitin 2016.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija za Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova
Agency on Management of Memorial of the Complexes of Kosovo

Raporti Vjetor i Punës së AMKMK-së

për vitin 2015

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës

1. Përmbledhje Ekzekutive

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës është themeluar në vitin 2013 pas hyrjes në fuqi të Ligjit Nr.04/L-146 të AMKMK-së, pas publikimit të GZRK/Nr.9/ datë 26.04.2013.

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale është organ i pavarur, që merret me planifikimin, projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës.

AMKMK do të paraqesë raportin vjetor përkitazi me të gjitha aktivitetet relevante lidhur me zbatimin e Ligjit të AMKMK- së.

Agjencia për punën e vet i raporton një herë në vit Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Në përgjithësi, Agjencia trajton, mbikëqyrë, menaxhon çështje të ndryshme lidhur me Komplekset dhe Memorialet, duke nxjerrë vendime, rekomandime, duke hartuar Akte nënligjore dhe nxjerrë Memorandume dhe Marrëveshje Bashkëpunimi në bashkëpunim me nivelin lokal dhe qendror.

Në këtë raport po i theksojmë objektivat kryesore e që janë: korniza ligjore, buxheti i AMKMK-së, rritja e numrit të stafit të Agjencisë, sigurimi i zyrave të reja për stafin e AMKMK-së, bartja e projekteve nga MMPH dhe automjeteve për punëtorë.

Arritjet e AMKMK-së për vitin e raportimit 2015 janë: përmbushja e infrastrukturës ligjore sidomos nxjerrja e legjislacionit sekondar në tërësi, realizimi i objektivave të disa projekteve duke pasur parasysh buxhetin e vogël, plotësimi i stafit (punësimi i dy ciceronëve në K M “Adem Jashari” Prekaz) sipas Ligjit të Buxhetit për vitin 2015.

Sfidat në të ardhmen mbeten rritja e buxhetit të AMKMK-së, për planifikimin, projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e shumë Komplekseve Memoriale të Kosovës dhe shtimi i numrit të punëtorëve për shkak të angazhimeve në kryerjen e punëve në të gjitha Departamentet dhe Divizionet e Agjencisë, bartja e të gjitha projekteve nga MMPH në AMKMK dhe vendosja në një objekt ku do të ketë hapësirë të mjaftueshme për punë.

2. Korniza Ligjore

Agjencia është formuar në pajtim me Ligjin Nr.04/L-146 për AMKMK, dhe që është baza ekzistuese ligjore që e rregullon, deri me tani në këtë Agjenci janë nxjerrë disa Akte nënligjore:

Udhëzimi Administrativ Nr.01/2014 për Stemën e Agjencisë së AMKMK-së, Rregullorja e Brendshme Nr.02/2014 për Sistematizimin e vendeve të punës në AMKMK, Rregullorja Nr.03/2014 për punët në teren, punët shtesë dhe jashtë orarit, Rregullore Nr.04/2014 për caktimin e shpenzimeve të telefonave mobil dhe fiks të AMKMK-së dhe tani është hartuar Projekt Udhëzimi Administrativ për përcaktimin e kritereve për Komplekset dhe Memoriale të Kosovës që bazohet në Ligjin e AMKMK-së.

Agjencia deri me tani nuk ka pasur vështirësi në zbatim të Ligjit.

Deri në periudhën raportuese ju informojmë se në vitin 2015 AMKMK ka paraqitur kërkesë Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor të Kuvendit për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/39 për Shpalljen e Kompleksit Përkujtimor "Adem Jashari" në Prekaz-zonë me interes të veçantë nacional. Deri më tani AMKMK ka hartuar një draft të projektligjit dhe memorandum shpjegues, ndërsa për të përgatitur dhe kontribuar në këtë Projektligj është e angazhuar edhe Oda e Avokatëve të Kosovës në bashkëpunim me Komisionin funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor.

Oda e Avokatëve të Kosovës do ta hartoj një draft të këtij Projektligji të cilin do të ia dorëzoi Komisionit FunkSIONAL BPMPH dhe pastaj ky Komision do ta procedoj për aprovim në Kuvend.

3. Përshkrimi i Institucionit (Organizimi Institucional)

Misioni: Krijimi i mundësisë për funksionimin e Agjencisë në pajtim me Ligjin në fuqi, duke u bazuar në Planifikimin, projektimin, ndërtimin dhe Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, dhe është kompetent për të gjitha Komplekset dhe Memorialet e Kosovës.

Vizioni: Kompletimi dhe funksionimi i Agjencisë, angazhimi në ngritjen dhe funksionalizimin e Komplekseve Memoriale dhe krejt kjo në funksion të shtimit të numrit të vizitorëve.

Agjencia është përgjegjëse për menaxhimin e Komplekseve Memoriale të shpallura me vendim të Kuvendit si Zona me interes të veçantë kombëtarë dhe më karakter historik:

- Projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare;
- Përcaktimin e programeve kërkimore - shkencore, aktiviteteve dhe manifestimeve të ndryshme, që kanë të bëjnë me zonat dhe historinë e tyre;
- Bashkëpunimin me institucionet qeveritare dhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, Komunitetet përkatëse, Agjencitë turistike, për projektet që kanë të bëjnë me këto zona;
- Krijimin e Web-Faqes dhe mirëmbajtjen e linçeve të veçanta për Komplekse Memoriale, si dhe publikon revistën vjetore;
- Inicimin e procedurës për shpalljen e Zonave me interes të veçantë dhe përgatitë propozim vendimin për miratim në Kuvend;
- Hartimin e planeve hapësinore, urbane dhe rregulluese të Zonave me interes të veçantë, që kanë të bëjnë me Komplekset Memoriale;
- Hartimin e planeve për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale;

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës ka dy Departamente: Departamentin për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme dhe Departamentin për Planifikim, Projekte dhe Menaxhim i cili ende nuk është funksionalizuar për shkak të mungesës së buxhetit.

4. Fushëveprimi që e mbulon Institucioni

Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës në strukturën organizative nuk ka Bord.

Agjencia deri me tani është duke funksionuar me stafin administrativ dhe dy ciceron në Kompleksin Memorial "Adem Jashari"-Prekaz.


Struktura e AMKMK-së është si në vijim:

- Drejtori i AMKMK-së dhe personeli mbështetës;
- Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme;
- Departamenti për Planifikim Projektim dhe Menaxhim të K.M.

Kapacitetet ekzistuese të AMKMK-së janë:

- Drejtori i AMKMK-së;
- Drejtori i DFSHP-së;
- Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa;
- Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit;
- Udhëheqës i Divizionit Ligjor;
- Zyrtare për Burime Njerëzore;
- Zyrtar i Logjistikës;
- Asistente Administrative;
- Zyrtar për Arkiv;
- Cicerona.

Organogrami i AMKMK-së



Numri i të Punësuarve në AMKMK në vitin 2015

Të Punësuarit në AMKMK		
Nr.	Emri Mbiemri	Pozita
1.	Idriz Blakaj	Drejtor i AMKMK-së
2.	Adnan Elshani	Drejtor i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
3.	Besim Mulaj	Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit
4.	Albana Hajrizi - Kunushevc	Udhëheqëse e Divizionit për Buxhet dhe Financa
5.	Arbër Këpuska	Udhëheqës i Divizionit Ligjor
6.	Sanie Elezi	Zyrtare e Burimeve Njerëzore
7.	Kastriot Ukaj	Zyrtar i Logjistikës
8.	Anita Balaj	Asistente Administrative
9.	Ferki Karaxha	Zyrtar i Arkivit
10.	Ilaz Halimi	Ciceron
11.	Xhevat Imeri	Ciceron

Nevojat për punëtor të rinj në AMKMK për vitin 2016

Në Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës aktualisht janë të punësuar njëmbëdhjetë (11) punëtor, duke përfshirë Drejtorin e AMKMK-së që është i emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Nevojat për punëtor të rinj në AMKMK janë:

Zyra e Drejtorit

Zyrtar Certifikues një (1) – parashihet avancimi në pozitën Zyrtar Certifikues,

Zyrtar i Lartë i Prokurimit –(1)

Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme

Menaxher i Personelit një (1) - parashihet pozita për Menaxher të personelit sipas Rregullores së brendshme.

Departamenti për Projektim Planifikim dhe Menaxhim të Komplekseve

- Drejtor i Departamentit për Planifikim, Projektim dhe Menaxhim të K.M. - një (1);
- Udhëheqës të Divizionit për Planifikim, Projektim të K.M. – një (1);
- Udhëheqës të Divizionit për Menaxhim të K.M. – një (1);
- Ciceron – pesë (5).
- Roje - gjashtëmbëdhjetë (16).

Tabela e Trajnimeve të kryera gjatë vitit 2015

Fusha e trajnimit	Tema e trajnimit	Ofruesi i trajnimeve	Numri i nëpunësve
Trajnime nga fusha e Burimeve Njerëzor	Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore	MAP	1
	Menaxhimi i Personelit – Sistemi Informativ i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore – Komunikimi Institucional dhe Teknologjia Informative	European Center	1
Administratë dhe Legjislacion	E drejta e qasjes në dokumente publike/zyrtare	IKAP	2
	Përafrimi i Legjislacionit vendor me Legjislacionin e bashkimit Evropian	IKAP	2
	Komunikimi dhe Hartimi i shkresave në Administratën Publike	IKAP	1
Prokurimi Publik	Prokurimi Publik dhe Menaxhimi i Kontratave	European Center	1
	Prokurimi Publik Bazik	IKAP	1

Buxhet dhe Financa	Moduli i Aprovimeve dhe Blerjeve Zotimet dhe Kërkesa për Blerje në SIMFK - V7	Ministria e Financave - Thesari	1
	Moduli i Pasurive SIMFK – V7	Ministria e Financave - Thesari	1
	Moduli i Blerjeve – Kërkesat për Blerje	Ministria e Financave - Thesari	1
	Moduli i Blerjeve – Zyrtar i pranimit të Mallit SIMFK - V7	Ministria e Financave - Thesari	1
	Moduli i Shpenzimeve – Zyrtar për Shpenzime	Ministria e Financave - Thesari	1
	Moduli i Shpenzimeve – Zyrtar Certifikues / Aprovues SIMFK - V7	Ministria e Financave - Thesari	1
	Pamjet në Raporte SIMFK – V7	Ministria e Financave - Thesari	1

PLANI VJETOR I TRAJNIMIT I NËPUNËSVE CIVIL
për periudhën Janar 2016 – Dhjetor 2016

Nevojat për trajnim	Numri i nëpunësve civil që duhen trajnuar	Përshtatja * me prioritetet e trajnimit	Titulli i programit/kursit të trajnimit dhe kohëzgjatja e tij (nëse dihet)	Ofruesi i trajnimit (nëse dihet)	Afati i parapëlqyer
Menaxhim i përgjithshëm					
	2	Nga këndvështrimi i institucionit, dhe nevojat individuale	Lidershipi dhe menaxhimi		Shkurt
	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Hartimi, zbatimi, koordinimi dhe monitorimi i politikave		Mars
	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Planifikimi dhe vendimmarrja		Prill
	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Bazat e menaxhimit		Maj
		Nga këndvësh. i institucionit, dhe	Menaxhimi Strategjik		Qershor

	2	nevojat individuale.			
	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Sjellje organizative		Tetor
	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Menaxhimi i inovacioneve		Nëntor
Trajnime nga fusha e Burimeve Njerëzore					
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Vendosja e objektivave dhe vlerësimit të rezultateve në punë		Shkurt
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Planifikimi, Rekrutimi dhe përzgjedhja		Mars
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Kodi etik, Të drejtat dhe përgjegjësit në shërbimin civil		Prill
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Transferimi dhe promovimi në shërbimin civil		Maj
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Ankimimi dhe çështjet e disiplinës		Tetor
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Vlerësimi i nevojave për trajnim dhe ndërtimi i planave të trajnimit		Nëntor
Administratë Legjislacion					
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Vlerësimin e ndikimit rregullativ dhe hartimi i koncept dokumenteve		Shkurt

	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Procedura administrative		Mars
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Organizimi dhe funksionimi i Administratës Publike		Prill
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Komunikimi dhe hartimi i shkresave në administratën publike		Tetor
Prokurimi Publik					
	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi i mallrave		Shkurt
	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi i Shërbimeve		Mars
	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi për punë		Prill
	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Standardet Ndërkombëtare dhe Legjislacioni i Prokurimit Publik		Maj
	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi elektronik – (pranimi i ankesave në mënyrë elektronike ¹)		Qershor
	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Trajnimit e avancuar për prokurimi publik		Shtator
	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Prokurimi Publik Parimet bazë Zbatimi i kontratave		Tetor

	2	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Krahasimi i legjislacionit për PP me vendet e BE-së		Nëntor
Buxhet dhe Financa					
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Hartimi i Pasqyrave Nëntë Mujore (PNM)		Shkurt
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Hartimi i Pasqyrave Vjetore Financiare (PVF)		Mars
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Kontrolli dhe Menaxhimi i Brendshëm Financiar		Prill
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Menaxhimi i financave publike		Tetor
	1	Nga këndvësh. i institucionit, dhe nevojat individuale.	Partneriteti publiko-privat		Nëntor

4.5 Asetet që ka në disponim AMKMK

Id e Artikullit të Pasurisë	Përshkrim i Artikullit të Pasurisë	Kodi i Klasës së Pasurisë	Përshkrim i Klasës së Pasurisë	Vlera origjinale	Ndryshim i vlerës	Amortizimi	Vlera në libër
20060000 00000969	AUTOMJET NISAN TERRANO II	31700	AUTOMJETE TRANSPORTI	21,036.00	0.00	21,036.00	0.00
20140000 00007377	NDËRTIMI I GYFIT PËR FURNIZIM	31400	UJESJELLES	795,114.95	0.00	31,804.59	763,310.36
20140000 00007393	KRIJIMI I WEB- FAQES SË AMKMK-	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	6,850.00	0.00	856.25	5,993.75
20140000 00007610	DEFINIMI I KUFIRIT TE Z.V K.M	31900	KAPITAL TJETER	39,499.74	0.00	4,937.46	34,562.28
20140000 00007616	MIRËMBAJTJA E K.M- A.JASHARI--	32500	INVESTIMET NE VIJIM	28,480.14	0.00	0.00	28,480.14
20140000 00007623	MBIKQYRJA E PROJEKTIT NDERTIM	31400	UJESJELLES	9,780.28	0.00	391.21	9,389.07

20140000 00008145	HARTIMI I PLANIT TË MENAXH. K	31900	KAPITAL TJETER	44,900.00	0.00	4,490.00	40,410.00
8743	NDERTIMI I RRUGËS	31200	NDERTIMI I RRUGEVE	9,870.56	0.00	41.13	9,829.43
8900	PUNËT SHITESË	32500	INVESTIMET NE VIJIM	28,813.59	0.00	0.00	28,813.59
8903	HARTIMI I PROJEKTIT	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,790.00	0.00	81.58	9,708.42
8906	MATJET GJEOMEKANIK E	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,893.00	0.00	164.88	9,728.12
9203	PLOTESIM I PROJEKTIT	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,569.60	0.00	239.24	9,330.36
9208	KANALIZIMIT ATMOSFERIK	31250	KANALIZIMI	9,962.00	0.00	0.00	9,962.00
9211	HARTIMI I TERMAVE TE REFERENCE	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,490.00	0.00	316.33	9,173.67
9215	ELABORATIT I SHPRONËSIMIT	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,789.00	0.00	571.02	9,217.98
10141	MBIKËQYRJA E PUNIMEVE - PENUHË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,800.00	0.00	81.67	9,718.33
10146	MBIKËQYRJA E PUNIMEVE - MARINË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,689.00	0.00	0.00	9,689.00
10147	MBIKËQYRJA E PUNIMEVE - KOSHARE	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	9,950.00	0.00	0.00	9,950.00
10255	EKZEKUTIMI I PUNEVE- PENUHË	32500	INVESTIMET NE VIJIM	300,200.00	0.00	0.00	300,200.00
10262	NDERT.I K.M"BETEJA E KOSHARES"	32500	INVESTIMET NE VIJIM	569,838.60	0.00	0.00	569,838.60
10269	PUNËT SHITESË- KOSHARE	32500	INVESTIMET NE VIJIM	37,877.50	0.00	0.00	37,877.50
10282	EKZEKUTIMI I PUNEVE- MARINË	32500	INVESTIMET NE VIJIM	226,253.20	0.00	0.00	226,253.20
10290	PUNËT SHITESË- MARINË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	31,329.58	0.00	0.00	31,329.58
10294	MIRËMBAJTJA E K.M"ADEM JASHARI	32500	INVESTIMET NE VIJIM	132,907.00	0.00	0.00	132,907.00
10305	MIRËMBAJTJA E WEB-FAQEVE	32500	INVESTIMET NE VIJIM	1,800.00	0.00	0.00	1,800.00

10309	SANIMI I DËMEVE- PENUHË	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	30,967.74	0.00	0.00	30,967.74
10669	HART.PROJEKT IT TË KONZERVIMIT	31900	KAPITAL TJETER	491,964.00	0.00	24,598.20	467,365.80
10672	MIRËMBAJTJA E WEB-FAQES K.M	32200	PASURI FIKSE TE PAPREKSHME	3,349.92	0.00	195.41	3,154.51
Total				2,898,765.40	0.00	89,804.97	2808960.43

AMKMK-ja, planifikon për asetet në të ardhmen që të menaxhojë me të gjitha Komplekset Memoriale të Kosovës, përkatësisht investimet kapitale të bëra në këto Memoriale.

Hapësira për punë:

AMKMK-ja është e vendosur përkohësisht në dy zyre të Kuvendit të Kosovës dhe aktualisht nuk kemi Zyre të Agjencisë. Është bërë kërkesa në MAP për sigurimin e zyreve të AMKMK-së.

Deri më tani nuk kemi hapësira për zyrat ku do të mund të vendoset stafi i AMKMK-së.

5. Aktivitetet për Periudhën Raportuese

Aktivitetet të cilat janë ndërmarr gjatë vitit 2015

- Bartja e projekteve të Komplekseve dhe Memorialëve nga MMPH sipas Ligjit për Agjencinë në AMKMK të cilat deri me tani janë bartur pjesërisht, ndërsa pjesa tjetër pritet të barten deri në fund të vitit;
- Ekzekutimi i buxhetit për vitin 2015;
- Planifikimi buxhetor për vitin 2016;
- Ekzekutimi i planit të prokurimit për vitin 2015;
- Planifikimi i prokurimit për vitin 2016;
- Planifikimi i personelit për vitin 2016;
- Punësimin e stafit të nevojshëm pa të cilët nuk do të mund të funksionoj Agjencia;
- Hartimi i projektit final ekzekutues për Konservimin e shtëpive të Rezistencës në K.M “Adem Jashari”;
- Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e K.M “Adem Jashari”;
- Mirëmbajtja e web-faqes së K.M Adem Jashari – Prekaz Skenderaj dhe web-faqes së AMKMK-së;
- Inicimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/39 për Shpalljen e Kompleksit Përkujtimor “Adem Jashari” në Prekaz-Zonë me Interes të veçantë nacional;
- Hartimi i elaboratit të shpronësimit në K.M “Adem Jashari” ;
- Hartimi i termave të referencës për shpalljen e planit urbanistikë në K.M “Adem Jashari”;
- Funkcionalizimi i objektit të recepsionit në K.M “Adem Jashari”-Prekaz;
- Ekzekutimi i punimeve të fazës së dytë në K.M “Beteja e Koshares”- Koshare;
- Hartimi për plotësimin e projektit të K.M “Beteja e Koshares”-Koshare;
- Mbikëqyrja profesionale në ekzekutimin e punimeve të ndërtimit të fazës së dytë të K.M “Beteja e Koshares”-Koshare;
- Ekzekutimi i punimeve të fazës së tretë dhe sanimi i dëmeve në K.M “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së”- Marinë , Skenderaj;
- Matjet gjeo-mekanike në K.M “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së”- Marinë, Skenderaj;
- Riprojektimi i projektit të “Varrezave të Dëshmorëve të UÇK-së”- Marinë, Skenderaj;
- Ekzekutimi i kanalit të ujërave atmosferike në K.M “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së”- Marinë , Skenderaj;
- Mbikëqyrja profesionale e punimeve në K.M “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së”- Marinë , Skenderaj;
- Ekzekutimi i punimeve në K.M “Dëshmorët e UÇK-së”- Penuhë, Podujevë;
- Ndërtimi i rrugës në K.M “Dëshmorët e UÇK-së”- Penuhë, Podujevë;
- Mbikëqyrja profesionale e punimeve në K.M “Dëshmorët e UÇK-së”- Penuhë, Podujevë;
- Ekzekutimi i punimeve për sanimin e dëmeve në K.M “Dëshmorët e UÇK-së”- Penuhë, Podujevë;

- Hartimi i Akteve nënligjore tjera;
- Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2016-2018;
- Planifikimi i Buxhetit të AMKMK-së sipas Qarkoreve Buxhetore;
- Hartimi i Raportit dhe Pasqyra Financiare për periudhën vjetore dhe nëntë mujore të vitit 2015;
- Raportimi mujor i obligimeve të papaguara gjatë vitit 2015;
- Barazimi i shpenzimeve të AMKMK-së me Departamentin e Thesarit çdo tre muaj;
- Hartimi i planit vjetor të punës së AMKMK-së për vitin 2016;
- Komisioni i formuar vitin e kaluar në mes MMPH-së dhe AMKMK-së për bartjen e të gjitha projekteve kapitale në AMKMK që kanë të bëjnë me Komplekset Memoriale, e që aktualisht janë si projekte në vazhdimësi të MMPH-së. Komisioni ende nuk e ka përfunduar punën, por planet janë që pas kryerjes së të gjitha obligimeve që ka MMPH ndaj operatorëve ekonomik t'i barten AMKMK-së të gjitha Komplekset Memoriale dhe të menaxhohen nga AMKMK.

- Planet që parashikohen për vitin - 2016:

- Bartja e të gjitha projekteve nga MMPH në AMKMK që kanë të bëjnë me komplekset dhe memorialet;
- Inicimi i procedurave të Prokurimit për fillimin e ekzekutimit të konservimit të shtëpive të rezistencës në Kompleksin Memorial Adem Jashari Prekaz Skenderaj, rishpallja e konkursit për hartimin e projektit të përgjithshëm Urbanistik. Blerja dhe mbjellja e 59 fidanëve simbol i të rënëve në Betejën e 5, 6, 7 Mars 1998;
- Mirëmbajtja e K.M Adem Jashari – Prekaz, Skenderaj;
- Hapja e Mini-Muzeut në K.M “Adem Jashari”-Prekaz;
- Vazhdimi i punimeve të fazës së dytë dhe përfundimi i kësaj faze, si dhe Inicimi i procedurave për ekzekutimin e punimeve në Kompleksin Memorial Beteja e Koshares-Koshare Gjakovë - faza e tretë;
- Inicimi i procedurave për ekzekutimin e punimeve në ndërtimin e varrezave të dëshmorëve dhe rivarrimi i tyre në Kompleksin Memorial Dëshmoret e UÇK-së-Penuhë -Podujevë;
- Mirëmbajtja dhe ruajtja e K.M “Dëshmorët e UÇK-së- Penuhë -Podujevë”;
- Mirëmbajtja dhe ruajtja e K.M “Kulla e Zahir Pajazitit”- Orllan, Podujevë;
- Ekzekutimi i punimeve në K.M “Masakra e Raçakut” – Raçak, Shtime;
- Ngritja e shtatores së mikut të shqiptarëve William Walker, Raçak, Shtime;
- Hartimi i Projektit dhe Ekzekutimi i punimeve të K.M “Dëshmorët e Kombit” – Vrellë, Istog - faza e parë;
- Përzgjedhja e kompanisë profesionale mbikëqyrëse për mbikëqyrjen e ekzekutimit të projekteve të AMKMK-së;
- Blerja e veturave për AMKMK-në;
- Ngritja e kapaciteteve të stafit, trajnime dhe seminare;
- Mirëmbajtja e web-faqes së AMKMK-së dhe K.M Adem Jashari, Prekaz – Skenderaj;
- Bashkëpunimi me Institucionet vendore dhe ndërkombëtare;
- Plotësimi i stafit me punëtor të ri;

- Hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit të AMKMK-së;
- Lidhur me këto AMKMK ka zhvilluar aktivitet duke bërë kërkesat për rritjen e stafit dhe për projekte kapitale në Ministri të Financave.

Agjencia do të bëjë përpjekje për realizimin e këtyre çështjeve të rëndësishme që u përmendën më sipër.

6. Pjesa e fundit e raportit- rekomandimet / sfidat e Institucionit (Rritja e stafit, ndryshimi i Ligjit)

Gjatë vitit 2015 stafi i AMKMK-së është trajnuar dhe kualifikuar për detyrat shtesë të domosdoshme për funksionimin e punëve të agjencisë.

Agjencia prej themelimit ka pasur shumë sfida, si mungesa e buxhetit, mungesa e stafit, hapësira jo të mjaftueshme me zyre, mungesa e veturave, ngecja dhe mos bartja e të gjitha projekteve nga MMPH në AMKMK.

Prandaj, për t'i realizuar tërë objektivat duhet të bëhet ndarja e buxhetit të mjaftueshëm, sipas parashikimeve tona, si:

-Rritja e numrit të punëtorëve të AMKMK-së: punësimi i stafit në Qendër, punësimit të ciceronëve, rojeve dhe mirëmbajtja;

-Rritja e buxhetit për projekte kapitale- Komplekseve Memoriale;

-Rritja e buxhetit për mallra dhe shërbime si dhe

-Është e domosdoshme rritja e buxhetit për shpenzime komunale me qëllim të kryerjes së të gjitha obligimeve, sepse ndarja e mjeteve buxhetor në këtë linjë i mbulon shpenzimet për të gjitha komplekset dhe memorialët vetëm 25%. Andaj kërkojmë që për kryerjen e këtyre obligimeve pa probleme të ndahen mjete të mjaftueshme financiare.

Rekomandojmë se për funksionalizimin e agjencisë duhet të merren më seriozisht Komisioni funksional BPMPH, Komisioni për Buxhet dhe Financa në kuadër të Kuvendit të Kosovës dhe në anën tjetër edhe Qeveria dhe Ministria e Financave.

Duke pasur parasysh numrin e madh të Komplekseve dhe Memorialeve në Kosovë që parashihen të ndërtohen, menaxhohen dhe disa të ndërtuara më herët që janë dëmtuar e që duhet patjetër të sanohen, është e domosdoshme që të kemi buxhet dhe staf të mjaftueshëm.

Planifikimi për vitin e ardhshëm do të fokusohet në arritjen e këtyre objektivave, me qëllim të ngritjes, menaxhimit të Komplekseve dhe Memorialeve që janë përgjegjësi e AMKMK-së, njëkohësisht bashkëpunimi dhe bashkërendimi i punëve me institucionet tjera.

7. Raporti Financiar

Shpenzimet e buxhetit të AMKMK-së për vitin 2015:

	Buxheti vjetor me Ligjin e Buxhetit (2015)	Buxheti me Rishikim Buxhetor 2015	Buxheti përfundimtar 2015	Shpenzimet 2015 €	Buxheti i shpenzuar (%)
Paga dhe mëditje	78,558.00	67,742.00	74,519.46	74,519.46	100
Mallra dhe shërbime	55,500.00	44,535.00	41,642.48	40,917.47	98.25
Shpenzime komunale	9,250.00	9,250.00	28,084.49	28,084.49	100
Investimet kapitale	2,250,000.00	2,230,000.002	1,668,002.13	1,667,991.71	99.99
Totali	2,393,308.00	2,230,000.00	1,812,248.56	1,811,513.13	99.95

*Buxheti i AMKMK-së për vitin 2015 është paraqitur detaj në Raportin Vjetor Financiar sipas formularit të Kuvendit të Kosovës që do t'i bashkëngjitet si Aneks i këtij raporti.

*Ndarja finale e buxhetit në kategorinë e shpenzimeve komunale është rritur pas kërkesës së AMKMK-së në MF për transferim të mjeteve nga kapitalet në komunalë me vlerë prej 27,342.00€, për shkak të borxhit të madh në shpenzimet komunale dhe kërkesa e AMKMK-së është aprovuar nga MF.

*Me rishikim buxhetor AMKMK-ja ka pasur shkurtim në paga e mëditje dhe për kështin e muajit Dhjetor janë shtuar mjete me vlerë prej 6,727.53€ nga ana e MF që të mbulohen pagat e AMKMK-së. Ndërsa ndarja finale e buxhetit e ka ndryshuar pas Vendimeve të Qeverisë për tërheqjen e mjeteve të lira të pashpenzuara dhe të pagat shtim i mjeteve.

8. Raportimi rreth adresimit të Rekomandimeve të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm

Nr	Rekomandimi ose gjetja	Veprimi i ndërmarrë ose propozuar	Afati i zbatimit	Efekti
1	Plani për hartimin e PVF të vitit 2015 të adresojë formalisht të gjitha kërkesat e pajtueshmërisë lidhur me PVF.	Pajtueshmërine me Rregullës Financiare nr. 03/2013; Kërkesat e LMFP-së nr, 03/L-048; Si dhe kërkesat tjera për raportim të nxjerra nga MF	Gjatë vitit 2015-2016	Pasqyrimi i drejtë i PVF
2	Sigurimi për dorëzimin e raporteve lidhur me obligimet e papaguara në baza të rregullta mujore për vitin 2015.	Zbatimi Rregullës Financiare 02-2013 për Raportimin e Obligimeve të Papaguara	Gjatë vitit 2015-2016	Raportimi i rregullt mujor për obligimet e papaguara
3	Niveli i ulët i realizimit të buxhetit në investimet kapitale (68%). Shpërputhje me planin e rrjedhës së parasë.	Monitorimi në mënyrë sistematike të performancës buxhetore në baza mujore dhe identifikimin, adresimin e barrierave për të planifikuar nivelet e realizimit të buxhetit.	Gjatë vitit 2015-2016	Planifikimi i duhur i shpenzimet të buxhetit.
4	Pagesa e avansit për investime kapitale prej 73,794€ është regjistruar gabimisht në kodin 31900.	Avanset për investime janë regjistruar në kodin 31910 - Avans për investime. Sigurimi që të gjitha shpenzimet të regjistrohen konform planit të aprovuar kontabël.	Gjatë vitit 2015-2016	Regjistrimi i shpenzimeve në kodet e gabuara ekonomike mund të shkaktojë keq prezantim të tyre në PVF.

5	Kompensimet për shërbime të bëhen konform marrëveshjeve dhe nga kategoritë adekuate të shpenzimeve.	Certifikimi i pagesave nuk bëhet asnjëherë pa u siguruar që mallra/shërbimet janë pranuar nga Agjencia në sasi dhe cilësi të duhur.	Gjatë vitit 2015-2016	Pagesat të bëra në kategori jo adekuate të shpenzimeve.
6	Shpalosje jo e saktë e obligimeve të papaguara ndaj furnitorit KUR Mitrovica	Formimi i komisionit në mes AMKMK-së dhe KUR Mitrovica me ç'rast është vërtetuar saktësia e leximit të njehsorëve të ujit dhe është bërë përmirësimi i faturave.	Gjatë vitit 2015	Raportimi i saktë dhe identifikimi i borxhit të AMKMK-së.

9. Shtojcat

Vendime të rëndësishme janë nxjerrë në AMKMK si:

- Vendimi për Formimin e Komisioneve të ndryshme për hapjen dhe vlerësimin e Ofertave në AMKMK;
- Për caktimin e menaxherëve për mbikëqyrjen e projekteve kapitale;
- Vendim për caktimin e ekspertëve vendor dhe të jashtëm për përcjelljen e punës në hartimin e projektit ideor dhe kryesor në konservimin e shtëpive të rezistencës në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" Prekaz- Skenderaj;
- Vendim për Komisione për rekrutimin e Shërbyesve Civil;
- Vendim për pranimin teknik të projekteve kapitale të cilat i ka investuar AMKMK;
- AMKMK gjatë vitit 2015 ka pranuar si donacion nga Ministria e Drejtësisë një veturë Toyota 4runner, e cila na ka lehtësuar punën në realizimin e aktiviteteve tona në terren.

Megjithatë, për funksionimin dhe plotësimin e stafit të AMKMK-së, duhet të theksojmë se është e domosdoshme të parashihet të ketë rritje të Buxhetit të Agjencisë nga Ministria e Financave. Mungesa e përkrahjes së nevojshme financiare deri me tani dhe trajtimi më serioz i kësaj çështje është një ndër sfidat kryesore në arritjen e objektivave të parashikuara të Agjencisë.

AMKMK do të përmbushë në mënyrë më efikase detyrat dhe përgjegjësitë të cilat i rregullon Ligji Nr.04/L-146 për Agjencinë për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës, me përkrahje nga Kuvendi i Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës.

Me respekt.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Agjencia Për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale të Kosovës
Agencija sa Upravljanje Memorialnih Kompleksa Kosova
Agency on Menagement of Memorial of the Complexes of Kosovo

AMKMK

DFSHP

Plani i Punës 2016

Kuvendi i Kosovës - Prishtinë

Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme
AMKMK
Dhjetor 2015

Aktivitetet e AMKMK - së Për vitin 2016

AMKMK është përgjegjëse për Komplekseve Memoriale në kuadër të zonave të veçanta në tërë territorin e Kosovë

Detyrat dhe Përgjegjësitë e AMKMK-së

Agjencia është përgjegjëse për menaxhimin e Komplekseve Memoriale të shpallura me vendim të Kuvendit si Zona me interes të veçantë kombëtarë dhe më karakter historik:

- Projektimin, ndërtimin, administrimin dhe menaxhimin e Komplekseve Memoriale, në përputhje me legjislacionin në fuqi, standardet vendore dhe ndërkombëtare;
- përcakton programet kërkimore - shkencore, aktivitetet dhe manifestimet e ndryshme, që kanë të bëjnë me zonat dhe historinë e tyre;
- bashkëpunimin me institucionet qeveritare dhe organizatat e dala nga lufta e UÇK-së, Komunitatet përkatëse, Agjencitë turistike, për projektet që kanë të bëjnë me këto zona;
- krijimin e VebFaqes dhe mirëmbajtjen e linçeve të veçanta për Komplekse Memoriale, si dhe publikon revistën vjetore;
- inicimin e procedurës për shpalljen e Zonave me interes të veçantë dhe përgatitë propozim vendimin për miratim në Kuvend;
- hartimin e planeve hapësinore, urbane dhe rregulluese të Zonave me interes të veçantë, që kanë të bëjnë me Komplekset Memoriale;
- hartimin e planeve për Menaxhimin e Komplekseve Memoriale;
- propozon shpalljen e Zonave me interes të veçantë kombëtarë dhe me karakter historik.

AMKMK gjatë vitit 2016 parasheh të kryej këto punë - aktivitete:

- I- Aktivitetet e Prokurimit;
- II- Në kuadër të Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme janë këto sektor me këto aktivitete; Financa, administratë – personel, logjistikë, legjislacion, TI & GIS;
- III- Në kuadër të Departamentit të Planifikimit Projektimit dhe Menaxhimit të Komplekseve dhe Memorialeve, janë këto aktivitete: planifikimi, ekzekutimi i punimeve, menaxhimi dhe ruajtja e tyre.

Paraqitja e aktiviteteve për 2016 sipas sektorëve:

I. Prokurimi:

- Përgatitja e kërkesave për Shpalljet e ndryshme, si: projektim, ekzekutim të punimeve, shërbime dhe furnizim etj;
- Pranimi i ofertave, hapja e tyre dhe vlerësimi;
- Shpallja e fituesve dhe lidhja e kontratave;
- Sipas nevojës takime në KRPP, OSHP, dhe takime tjera APP.

II. Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme gjatë 2016 parasheh të kryej këto aktivitete:

1. Administrata, personeli dhe informimi:

- Planifikimi i personelit: Përgatitja e planit të personelit në bashkëpunim me njësit organizative të AMKMK-së;
- Identifikimi i vendeve të lira të punës dhe parashikimi i kërkesës për staf sipas prioriteteve;
- Identifikimi i nevojave për trajnim të stafit;
- Menaxhimi i Sistemit Informativ për Burimet Njerëzore: moduli për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, moduli për administrim të nëpunësve etj.

- Përditësimi i dosjeve të personelit me të dhëna dhe dokumente relevante dhe kujdeset që të gjitha llojet e pushimeve të stafit janë proceduar në pajtim me procedurat ligjore;
- Punët e gjithmbarshme të njësisë së burimeve njerëzore dhe ndihmon mbikëqyrësin në caktimin e objektivave dhe hartimin e planit të punës për përmbushjen e këtyre objektivave;
- Siguron zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar lidhur me menaxhimin dhe zhvillimin e burimeve njerëzore;
- Siguron që listat e pagave të stafit të AMKMK – së janë përgatitur në pajtim me procedurat ligjore.
- Mbështetë punën e Komisionit për ankesa dhe parashtrës dhe Komisionit disiplinor;
- Punët për komunikim dhe informimi në Web - faqen e AMKMK-së.

2. Buxheti dhe Financat:

- Hartimi i cash flow-it 2016 për kategorinë paga & mëditje, mallra e shërbime dhe investime kapitale;
- Raportimi i obligimeve të papaguara gjatë vitit 2015 dhe që barten si obligime në vitin 2016;
- Barazimi i shpenzimeve të AMKMK-së me Departamentin e Thesarit për vitin fiskal Janar –Dhjetor 2015;
- Kërkesat për procedim të pagesave të ndryshme, zotimi i mjeteve për pagesa sipas afatit të zotimit, shpenzimi i pagesave, dhe çertifikimi (aprovimi) i pagesave;
- Menaxhimi i shpenzimit të buxhetit gjatë vitit fiskal 2016;
- Hartimi i Raportit Vjetor Financiar 2015 për Departamentin e Thesarit – MF;
- Hartimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve 2017-2019 të AMKMK-së;
- Raporti Vjetor Financiar 2015 për Kuvendin e Kosovës;
- Raporti dhe pasqyrat financiare 2016 tre mujore, gjashtë mujore dhe nëntëmujore të AMKMK-së;
- Barazimi i shpenzimeve të AMKMK-së dhe Departamentit të Thesarit për tre muaj, gjashtë muaj dhe nëntë muaj;
- Hartimi i kërkesave Buxhetore sipas Qarkoreve Buxhetore 01/2017; 02/2017 dhe 03/2017 duke përfshirë planifikimin e buxhetit operativ në sistemin BDMS dhe planifikimin e projekteve kapitale në sistemin e PIP-it;
- Hartimi i kërkesës buxhetore të AMKMK-së për rishikimin buxhetor 2016 në Ministrinë e Financave;
- Punë të tjera të cilat kërkohen sipas Ligjit të Buxhetit 2016 dhe Rregulloreve Financiare në fuqi për vitin fiskal 2016;

- Menaxhimi i shpenzimit dhe verifikimi i parasë së imët (petty cashit) e avanseve të AMKMK-së.

3. Legjislacioni:

- Plotësim ndryshimi i Projektligjit për Shpalljen e Kompleksit Memorial “Adem Jashari” Prekaz -Zonë e Veçantë me karakter nacional,
- ProjektUdhëzimi Administrativ për Përcaktimin e Kritereve për Komplekset Memoriale të Kosovës është hartuar mirëpo nuk është i miratuar nga Drejtori i AMKMK-së, pasi pritet të publikohet në web faqe të AMKMK-së për konsultime paraprake dhe publike në pajtim me Rreg. Nr.09/2011 për Punën e Qeverisë;
- Parashihet nxjerrja e Rregullores për Pranimin Teknik të Punëve dhe e akteve tjera nënligjore me qëllim të funksionimit sa më të mirë të Agjencisë;
- Hartimi i Strategjisë së AMKMK dhe planit të veprimit.

4. Logjistika:

- Ofrimi i ndihmës logjistike për takimet e personelit të Agjencisë;
- Menaxhimi i inventarit të AMKMK-së;
- Koordinimi i kërkesave dhe nevojave të Agjencisë për mallra dhe pajisje të zyrës për punë, furnizimi i zyrave me inventar të ri dhe material shpenzues;
- Menaxhimi i transportit dhe automjeteve të Agjencisë, mirëmbajtje dhe servisimi dhe Blerja e veturave për AMKMK;
- Bashkëpunimi në përgatitjen dhe hartimin e broshurave dhe revistave të Agjencisë;
- Mbështetje teknike për pajisjet e stafit (PC) etj;
- Mbështetje për projektet kapitale: Hapja e ofertave, Komisione për pranimet teknike etj;
- Inventarizimi i zyrave të reja dhe menaxhimi i inventarit.

5. IT- GIS:

- Shërbimet e IT – së dhe GIS – it do të vazhdojmë ti kryejmë nga IT ja e Kuvendit të Kosovës dhe në disa raste edhe IT e MAP – it pasi që neve nuk po na lejohet të punësojmë një zyrtar që do ti kryej këto punë;
- Do të vazhdojmë bashkëpunimin me Kompaninë “Kutia” e kontraktuar për mirëmbajtjen e web-faqes së AMKMK-së dhe K M “Adem Jashari” Prekaz, e cila po na ndihmon në kryerjen e disa punëve të GIS-it dhe TI-së;

III. Departamenti i Planifikimit Projektimit dhe Menaxhimit të Komplekseve dhe Memorialeve.

A. Këtë vit pritet të funksionalizojmë edhe këtë Departament, duke filluar nga Drejtori dhe pastaj punësimin edhe të ndonjë arkitekti apo inxhinieri si dhe disa roje. Mirëpo edhe pse MF nuk na ka lejuar mjete për paga dhe mëditje për punësimin e tyre punëtorëve, ne do të bëjmë përpjekje për të biseduar me MF dhe MAP duke ju sqaruar nevojën dhe rëndësinë e punësimit të punonjësve të lartë cekur. Shpresojmë që me rishikim buxhetor do të na mundësohet punësimi dhe funksionalizimi i këtij Departamenti.

Ky departament ka nën menaxhim Projektet Kapitale, pra Komplekset dhe Memorialet kështu që në kuadër të saj jemi duke ndërtuar planifikuar dhe menaxhuar këto Komplekse Memorialë.

Sa i përket Projekteve Kapitale kemi në plan si në vijim:

1. Kompleksi Memorial “Adem Jashari” Prekaz
 - Revidimi i Projektit të Konservimit;
 - Hartimi i Planit të Përgjithshëm Urbanistik;
 - Mbjellja e fidanëve, simbol i 59 të rënëve në Betejën e 5,6 dhe 7 Marsit;
 - Shpronësimin.
2. Mirëmbajtja e K M “Adem Jashari” Prekaz
3. Vazhdimi i Ndërtimit të fazës së dytë K M “Beteja e Koshares” Koshare.
 - Vazhdimi i punimeve të kësaj faze.
4. Ndërtimi i Fazës së tretë dhe evitimi i dëmeve në K M “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK – së Marinë Skenderaj”.
 - Vazhdimi i punimeve dhe përfundimi i kësaj faze pasi të jenë bartur varrezat e dëshmorëve.
5. Ndërtimi i Fazës së tretë në K M “Varrezat e Dëshmorëve të UÇK – së Penuhë Podujevë”
 - Përfshihen ndërtimi i varrezave dhe rivarrimi i eshtrave të dëshmorëve të zonës së Llapit.
6. Ndërtimi i fazës përfundimtare të K M “Masakra e Raçakut” Raçak- Shtime
 - Do të kryhet ndërtimi i pjesëve të mbetura nga projekti i këtij Memoriali.
7. Mirëmbajtja e K M “Kulla e Zahir Pajazitit” Orllan Podujevë.

8. Kompleksi Memorial “Dëshmorët e Kombit” Vrellë Istog.
 - hartimi i projektit dhe ekzekutimi i punimeve.
9. Blerja e veturave.
 - AMKMK ka nevojë për vetura, me qëllim që të kryej veprimtarinë e vet si duhet.

B. Gjatë vitit 2016 do të punojmë në drejtim të gjetjes së mundësive të financimit edhe të projekteve tjera që veç janë të futura në PIP- sistem dhe që pritet të ngriten duke filluar nga Planifikimi, Ndërtimi dhe në fund Menaxhimi i tyre.

10. Zona e veçantë “ Shtabi i Përgjithshëm i UÇK-së” Kleçkë dhe Divjakë – Malet e Berishës;
11. Memoriali Masakra e Likoshanit – Drenas (Konservimi i Shtëpive të Familjes Ahmeti);
12. Memoriali “Ibrahim Rugova dhe Varrezat e Dëshmorëve të UÇK-së” Prishtinë;
13. Memoriali “Baza e Parë e UÇK-së” Lladovc- Podujevë;
14. Kompleksi Memorial “Shtabi dhe Varrezat e UÇK-së Gllogjan Deçan;
15. Memoriali “Dëshmorët e UÇK-së Shqiponjë” (ish Jabllanica)” Gjakovë;
16. Memoriali “ Metush Krasniqi”- Dajkoc- Kamenicë;
17. Memoriali “Obelisku Afrim Zhitia” Lluga- Podujevë;
18. Memoriali “Dëshmorët” e UÇK-së” Landovicë- Prizren;
19. Konservimi i “Fshatit Memorial Strazhë” Kaçanik;
20. Projekti për Intervenime Emergjente në Komplekse Memoriale Varreza të Dëshmoreve dhe Martirëve etj.
21. Kompleksi Memorial “Dëshmorët e Kombit” Vrellë – Istog.

Me respekt